



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA UJËSJELLËS KANALIZIME PËRMET SH.A
AKSIONARI

Përmet më 30 / 05 / 2023

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Nr. 178, date 30 / 05 / 2023

Në mbështetje të, Ligjit, Nr. 9901/2008 “ Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” Neni 135, pika 2/c si dhe të Statutit të Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Përmet Sh.a, sot, më datë 30 / 05 / 2023, Ujësjetllës Kanalizime Përmet Sh.a, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me J692282203I, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga likuidatori dhe administratori i shoqërisë zoti, Florin Dauti për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Çështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Përmet Sh.a nuk zhvillon më aktivitet ekonomik e administrativ dhe ofrimin e shërbimit ndaj qytetarëve pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 2423Rep. dhe Nr. 799 Kol, datë 02.11.2022 midis shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Përmet Sh.a dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër Sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivitet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 31.12.2022, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Ortaku i Vetëm vendosi:

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Emërimin e Z. Florian Dauti si likuidator të shoqërisë.

(4) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u siguroa se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon:

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONAREVE
AKSIONAR I VETEM
PERFAQESUAR NGA**

KRYETARI

Alma HOXHA

